



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/I18-2 Prot.
Nr. Dok. 202300240/2

Tiranë 03.03.2023

Lënda: *Rekomandojmë përmirësimin e Udhëzimit nr.1 datë 5.12.2020, "Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet", të miratuar nga Komisioni Rregullator, në KQZ.*

**Drejtuar: Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve
Komisionit Rregullator**

Tiranë

Të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator,

Në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të cilat do të zhvillohen në datën 14 Maj 2023, institucioni i Avokatit të Popullit ka nisur punën për monitorimin paraprak të përgatitjeve për procesin zgjedhor. E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur është një e drejtë themelore e njeriut ndaj dhe vëmendja jonë e shtuar institucionale është përqëndruar tek garancitë e dhëna në respektimin e së drejtës së votës për qytetarët dhe nga ana tjetër, tek ushtrimi i kësaj të drejtë në mënyrë të lirë, të fshehtë dhe të pakushtëzuar, me akses të garantuar të qytetarëve në qendrat e votimeve në veçanti për personat me aftësi të kufizuara (PAK).

Të drejtat e garantuara në përgjithësi për personat me aftësi të kufizuara, kanë gjetur një detajim specifik, në kontekstin e realizimit të tyre në proceset zgjedhore, në parashikimet e kryera në ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, sa i takon lehtësimin të aksesit për personat PAK, në qendrat e votimit. Në procesin e votimit të shtetasve, në veçanti të zgjedhësve me përkatësi në grupin e personave PAK, logjistika e zgjedhjeve merr një rëndësi të veçantë. Në procedurën e votimit të drejtpërdrejtë, hapja e qendrave të votimit në të gjitha vendet e përcaktuara duhet të shoqërohet me sigurimin e logjistikës së nevojshme, e cila mundëson dhe lehtëson, votimin për të gjithë kategorinë e personave PAK. Mbi këtë bazë vlerësimi, duke analizuar të gjithë legjislacionin specifik në fuqi, në zgjedhjet e fundit parlamentare të mbajtura në vitin 2021, me tonën nr. K1/S4-2 datë 06.04.2021, i kemi rekomanduar Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, (Komisionit Rregullator), shprehimisht:

"1. Përmirësimin, në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, të Udhëzimit nr.1 datë 5.12.2020, "Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e

vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, të miratuar nga Komisioni Rregullator, në KQZ. Shtimin e parashikimeve të detajuara në këtë udhëzim, të cilat kanë të bëjnë me krijimin e lehtësive për votimin e personave PAK në qendrat e votimit, si dhe për çëshjtjet e tjera të parashtruara nga ana jonë në këtë rekomandim.

2. Parashikimin e një mekanizmi efektiv për kontrollin e përmbushjes së kriterëve ligjore nga ana e organeve përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilët qëllimojnë krijimin e kushteve të përshtatshme në qendrat e votimit, për ushtrimin lirisht të së drejtës së votës nga ana e personave më aftësi të kufizuar”.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, me anë të shkresës nr.3412/1 datë 7.05.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm, të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, na është pohuar se, ky institucion do të bëjë vlerësimin e përgjithshëm të problemeve të hasura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të zhvilluara në datën 25 Prill 2021, lidhur me infrastrukturën mbështetëse e cila ngrihet tërësisht sipas një mekanizmi, kriteresh, afatesh dhe ndërveprimi institucional të mirëpërcaktuar. Duke u shprehur se, respektimi i kërkesave dhe kriterëve ligjore për qendrat e votimit dhe detyrimi ligjor për t’u garantuar personave më aftësi të kufizuara, të drejtat politike dhe mundësinë për të votuar, është prioritet i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, në përgjigjen e sipërcituar garantohej shtimi i parashikimeve të detajuara në aktet nënligjore të këtij institucioni, për krijimin e lehtësive për votimin e personave PAK, në qendrat e votimit në të ardhmen (pasi zgjedhjet e datës 25 Prill 2021 u kryen me bazën aktuale ligjore në fuqi në atë kohë).

Aktualisht, strukturat përkatëse të Komisionit Qëndror i Zgjedhjeve vërehet se kanë filluar prej kohësh nga puna për përgatitjen e kuadrit të nevojshëm rregullator në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme të muajit Maj, në përputhje me programin analitik të akteve për zgjedhet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023¹. Të gjitha aktet (vendimet, urdhrat e udhëzimet) janë publikuar në faqen zyrtare të KQZ. Referuar programit analitik të sipërcituar, vërehet se në numrin rendor 27 është parashikuar projekt-akti “*Për një ndryshim në udhëzimin nr.1/2020 për ngritjen e qendrave të votimit (kriteret teknike të ngritjes së infrastrukturës së nevojshme për personat PAK)*”, si akt amendues i cili duhet të miratohet nga Komisioni Rregullator. Megjithatë, nga verifikimi i kujdesshëm i akteve nënligjore të publikuara² nuk rezulton të jetë publikuar ndonjë akt nënligjor i cili rishikon/ndryshon Udhëzimin nr.1 datë 5.12.2020, “*Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet*”, sipas rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe konfirmimit zyrtar të dhënë nga ana e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve me shkresën nr.3412/1 datë 7.05.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm, të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

Sa më sipër, duke vendosur sërish theksin në rëndësinë e të drejtës për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur si një e drejtë themelore e shtetasve, e veçanërisht tek ushtrimi i kësaj të drejte në mënyrë të lirë, të fshehtë dhe të pakushtëzuar, me akses të garantuar të qytetarëve në qendrat e votimeve për personat me aftësi të kufizuara (PAK), si dhe nisur nga fakti se zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen në datën 14 Maj 2023 janë

¹ Miratuar me Vendimin nr. 209 datë 25.11.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, link: https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Vendim-nr.-209-date-25.11.2022_Miratim_matrica-akteve_2023.pdf

² Faqja zyrtare e KQZ, rubrika “*Akte të KQZ*”, link: <https://kqz.gov.al/akte-te-kqz-2/>, datë 28.02.2023

afër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës, dhe të nenit 24/b, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ,

REKOMANDOJMË

1. Përmirësimin, në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, para zgjedhjeve të ardhshme për organet e qeverisjes vendore, të Udhëzimit nr.1 datë 5.12.2020, “*Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet*”, të miratuar nga Komisioni Rregullator, në KQZ.

2. Shtimin e parashikimeve të detajuara në këtë udhëzim, të cilat kanë të bëjnë me krijimin e lehtësive për votimin e personave PAK në qendrat e votimit, si dhe për çështjet e parashtruara në rekomandimin nr. K1/S4-2 datë 06.04.2021 të Avokatit të Popullit.

3. Parashikimin e një mekanizmi efektiv për kontrollin e përmbushjes së kritereve ligjore nga ana e organeve përkatëse të njësisë të vetëqeverisjes vendore, të cilët qëllimojnë krijimin e kushteve të përshtatshme në qendrat e votimit, për ushtrimin lirisht të së drejtës së votës nga ana e personave më aftësi të kufizuar.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se:

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet t’a shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndër marrë ai organ”,

lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Vilma SHURDHA